

11.03.2026

Për: Kuvendin e Komunes se Suharekes- Kryesuesit Bexhet
KUÇI

REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E SUHAREKES REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NE DOREZIM-PRIMLJENO-RECEIVED			
Org. Jedinica Org. Unit	Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	11550	7

Kopje; Komitetit për Politik dhe Financa

Nga : Kryetari i Komunës –Bali MUHARREMAJ

Lënda: Propozim

Te nderuar,

Me anë të kësaj shkrese kërkojmë nga Ju te nderuar që te jepet **pëlqimi** për ndarjen e mjeteve financiare, në shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë euro), Shoqatës Zona e Pashtrikut, për mbështetje financiare për realizimin e projektit për ngritjen e shtatores së dëshmorit të atdheut, Tahir Sinani, në qytetin e Prizrenit, i cili ka kontribuar në organizimin e njërive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në operacionet luftarake të njërive të UÇK-së.

Bashkangjitur me këtë shkresë keni; Dokumenta tjera përcjellse për te cilën kan kerkuar mbeshtje finaciare kjo shoqatë.

Mbesim me shpresë se propozim jonë do të hasë në mirëkuptim.

Me datë 11.03.2026

Me respekt

Propozuesi,
Kryetari i Komunes
Bali MUHARREMAJ



SHOQATA ZONA E PASHTRIKUT

LËNDA: KËRKESË

- Drejtuar kryetarit të komunës së Suharekës, gjegjësisht Asamblesë Komunale Suharekës, që në bazë të kërkesave të bëra më heret nga Organizata e Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve dhe në bazë të zotimit të kryetarit të komunës dhe stafit të tijë, të mundësohet financimi për projektin e shtatorës së Heroit Tahir Sinani (ish-kom. të Zonës së Pashtrikut) në shumën prej dhjetë mijë euro (10,000), e cila shtatore është ngritur nën patronatin e Kryetarit si dhe me financimin e të gjitha komunave të Zonës së Pashtrikut përfshi komunën e Suharekës Zt.Bali Muharremi.
- Shoqata - Zona e Pashtrikut ka udhëhequr të gjitha punimet dhe ka kërkuar ndihmë financiare edhe nga Komunitet tjerë të Zonës së Pashtrikut, në mënyrë që bashkarisht të përfundohet i gjithë projekti i shtatorës së Heroit të Kombit Tahir Sinani, projekt i cili nderon gjithë Kombin.
- Mbesim me shpresë që kërkesa jonë të realizohet në një afat sa më të shkurtër për shkak të obligimeve financiare që kemi ndaj kompanive (gjegjësisht skulptorëve dhe kompanisë së bronzit).

Bashkangjitur keni të dhënat e Shoqatës - Zona e Pashtrikut:

Nr. fiskal: 603219115

Emri i bankës: PRI BANK

IBAN: XK052440130500003932

Konto nr.: 2440130500003932

Shoqata - Zona e Pashtrikut



15.09.2025 Prizren



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA / MINISTRY OF
INTERNAL AFFAIRS**

**Departamenti për Regjistrimin e Organizatave Joqeveritare/ Departament za Registraciju Nevladine
Organizacije/ Department for Registration of Nongovernmental Organisation**

Certifikatë e Regjistrimit të OJQ-së
Uverenje za Registraciju NVO-a
NGO Registration Certificate

Kjo Organizatë Joqeveritare është regjistruar në bazë të nenit 22 Ligjit Nr. 06/L-043. Për Lirinë e
Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
Navedena Nevladina Organizacija je Registrovana na osnovu clana 22 Zakona Br. 06/L-043, O
Slobodi Udruživanja u Nevladnim Organizacijama u Republici Kosovu.
The following Non Governmental Organisation is Registered under Law No. 06/L-043, section 22
On Freedom of Association in Non-Governmental Organisations.

Nr. i Regjistrimit:
Br. Registracija:
Registration No:

5120654-1

Data e regjistrimit:
Datum Registracije:
Date Registered:

29/05/2024

Numri Fiskal:
Fiskalni Broj:
Fiscal Number:

603219115

Emri i plotë:
Puno Ime:
Full Name:

Shoqata Zona e Pashtrikut

Shkurtesa:
Skracenica:
Acronym:

SHZEP

Lëshuar më/ Izdato /Issued on:
29/05/2024



Bedri Zyberaj

Bedri Zyberaj

Drejtör / Direktor / Director

Nr. Serik
Br. Serije
Serial No.

014175

Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Prizren

K Ë R K E S Ë

Ne, Grupi vullnetar i punës për realizimin e projektit për ngritjen e një shtatoreje për dëshmorin e atdheut Tahir Sinani, parashtrojmë pranë kësaj organizate kërkesën si vijon:

Tahir Sinani lindur më 25 maj 1964 në fshatin Gri, afër Bujanit, rrethi i Tropojës në Shqipëri dhe ra dëshmor në frontin e luftës në radhët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare më 29 korrik 2001, në vendin e quajtur "Zabeli i Kukulit" afër qytetit të Gostivarit, në Maqedoni.

Ishte oficer i ushtrisë së Shqipërisë dhe një nga komandantët e shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili mori pjesë në Luftën e Kosovës, në Luftën e Kosovës Lindore dhe në Luftën Çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni në vitin 2001.

Më 24 maj të vitit 2002, trupi i dëshmorit Tahir Sinani rivarrosët në Varrezat e Dëshmorëve në Landovicë të Prizrenit ku përjetësisht pushon së bashku me dëshmorët e tjerë të kombit.

Vlerësuar si një luftëtar me vlera dhe me kontribute të veçanta në çështjen kombëtare dhe në luftën e drejtpërdrejtë kundër pushtuesve të trojeve shqiptare, është me vend që të ketë edhe një mjedis me emrin e tij dhe një shtatore të tij pranë atij mjedisi të vlerësuar për këtë çështje.

Tahir Sinani është vlerësuar nga bashkëluftëtarët për kontributin e madh në organizimin e njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në trajnimin e luftëtarëve, në planëzimin e luftimeve dhe në realizimin me sukses të detyrave luftarake. Ka gëzuar nderimin dhe respektin e gjithë hierarkisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj edhe gjatë luftës ka udhëhequr njësi të ndryshme deri në komandant Zone, detyre të cilën e kreu me nderë deri në Nentor të vitit 1999.

Pikërisht për këtë edhe mendimi dhe propozimi i grupit të punës duke u bazuar në aktivitetin atdhetar e luftarak, për jetesimin dhe nderimin e kësaj figure të rendesishme kombëtare është që shtatorja e Tahir Sinanit të ngrihet në qytetin e Prizrenit.

Për këtë ne kërkojmë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Dega në Prizren, të miratojë këtë projekt duke përcaktuar si mjedis të përshtatshëm, Parkun e qytetit të Prizrenit:

Parku i qytetit – kërkohet të emërtohet **"Parku Tahir Sinani"** dhe në një pozicion të përshtatshëm e të dukshëm të ngrihet edhe **shtatorja e heroit**.

Masat që mendojmë se duhet të merren dhe detyrat që duhet të zbatohen në procesin e përgatitjes dhe realizimit të kësaj veprimtarie për nderimin e figurës së dëshmorit të atdheut Tahir Sinani, i cili e ka zhvilluar karrierën deri në detyrën e komandantit të Zonës Operative të Pashtrikut dhe Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, si dhe ka përfunduar jetën duke rënë në frontin e Luftës Çlirimtare Kombëtare në vitin 2001, për të mbetur në altarin e kombit me lavdi, janë:

1. Njohja me legjislacionin e Republikës së Kosovës për nderimet që u bëhen dëshmorëve të atdheut;
2. Evidencimin e detyrave dhe gradave që ka fituar Tahir Sinani gjatë luftës dhe karrierës së tij deri në fund të jetës;
3. Vlerësimet që janë bërë për Tahir Sinanin nga institucionet shtetërore dhe shoqërore, titujt e dhënë dhe vlerësime të tjera;
4. Veprimtaritë dhe nderimet që janë bërë prej vitit 1999 e deri sot për Tahir Sinanin;
5. Në kuadër të këtij projekti grupi i punës ka mendimin që për figurën e dëshmorit të atdheut Tahir Sinani të mbahet edhe një konferencë shkencore.
6. Emërtimi dhe tezat mbi të cilat mendojmë se mund të ndërtohen kjo konferencë shkencore, vlerësojmë se mund të paraqiten si më poshtë:

Titulli i Konferencës mund të jetë:

**Veprimtaria ushtarake dhe luftarake e Tahir Sinanit
në shërbim të atdheut e kombit**

Disa nga tezat mbi të cilat do të mbështeten përpiluesit mund të jenë:

- Ushtria Çlirimtare e Kosovës në historinë kombëtare shqiptare,
- Ndikimi i fillimit të Luftës Çlirimtare në Kosovë në viset e Republikës së Shqipërisë,
- Tahir Sinani si figurë përbashkuese e idealeve të shqiptarëve për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare,
- Tahir Sinani – figurë e ushtarakut model në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,
- Trajnimi i njësisë të UÇK-së dhe roli i Tahir Sinanit në këtë veprimtari,

- Tahir Sinani njeriu që dha çdo gjë për çlirimin e trojeve të pushtuara të atdheut tonë,
- Operacionet luftarake të njësive të UÇK-së dhe Tahir Sinani,
- Vlerat e figurës së Tahir Sinanit për historinë shqiptare,
- Tahir Sinani si vlerë kombëtare,
- për lëvizjen tonë çlirimtare shqiptare në tërësi,
- për rrugën e gjatë të përgatitjes për rezistencë të armatosur,
- për Luftën Çlirimtare dhe drejtimin e saj,
- për gatishmërinë e njerëzve që të sakrifikohen për idealet e dashurisë ndaj atdheut, pa të cilat jeta jonë nuk do të kishte ecje vertikale,
- Vlerat e kuadrove ushtarakë për drejtimin e luftimeve të UÇK-së,
- Roli i Tahir Sinanit në edukimin atdhetar,
- Shfrytëzimi i përvojave në luftën e UÇK-së,
- Mbi metodën e punës së Tahir Sinanit në komunikim me luftëtarët, vartësit dhe eprorët, si dhe gjatë zbatimit të planeve e detyrave,
- Tahir Sinani dhe vendlindja e tij etj.

Shënim: Këto teza nuk janë detyruese për pjesëmarrësit, por janë orientuese, gjithsecili që merr përsipër të përgatisë një kumtesë për këtë figurë ose edhe për çështje që lidhen me të, mund të përzgjedhë vetë sipas mendimit dhe idesë që ka.

Ngritja e shtatores së dëshmorit është një akt nderimi që mund e duhet të bëhet për secilin dëshmor, duke krijuar kushte që të vlerësohet sa më plotësisht vepra e tij, prandaj edhe mendojmë se realizimi i këtij projekti duhet të gjej mbështetje nga të gjithë institucionet shtetërore e organizatat shoqërore.

Duke qëndruar në pritje të një përgjigje miratuese nga ana juaj, me shumë nderim e konsideratë të lartë,

Grupi i punës për udhëheqjen e realizimit të projektit

1. Prof. Dr. Kudusi Lama – Gjeneral në pension – kryetar,
2. Gjeneral Selim Abdyl Krasniqi – Zv/kryetar,
3. Ali Ahmeti – anëtar,
4. Shefket Musliu – anëtar,
5. OVL-UÇK – anëtar,
6. Alush Shala – anëtar,
7. Fetah Bekolli – anëtar,
8. Zenel Zekolli – anëtar,
9. Xhemshit Krasniqi – anëtar,
10. Skender Hoti – anëtar,
11. Bekim Morina – anëtar,

Handwritten signatures and notes:
 2.4.2009
 F.B.
 Z.4.
 Xhemshit Krasniqi
 Selim Abdyl Krasniqi

NR 04-351/02

DT. 09.02.20

Elbert

[illegible]